



Datë: 07.07.2025
Numër Protokolli: 4546/2025

A.nr.811/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës– Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari -kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani anëtarë, me Atdhe Gashi në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.811/2025, të datës 05.05.2025 të parashtruar nga ankuesi G.H, kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë , në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.07.2025 mori:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.811/2025 e datës 05.05.2025 e parashtruar nga ankuesi G.H.

A r s y e t i m

Ankuesi G.H(referuar më tutje si ankuesi) me datë 05.05.2025 ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës regjistruar nën shenjën A.nr.811/2025 e protokolluar me nr.2952/2025, me pretendimin ankimor lidhur me parregullsitë kundër procedurave të konkursit me nr.reference RN00017433 të datës 24.03.2025, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit, klasa e pozitës Drejtues i Ulët.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 26.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa me datë 27.05.2025, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen administrative në procedurë nga kjo e fundit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me shenjën A.nr.811/2025 me nr. protokolli 2952/2025 e datës 05.05.2025; Kopja e letërnjoftimit të ankuesit; Njoftimin e datë 02.05.2025 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MINT që njofton ankuesin që nuk plotëson kriteret për përfshirje në listën e ngushtë; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 26.05.2025; Përgjigje në ankesë e datës 27.05.2025; Konkursin me numër reference RN00017433 të datës 24.03.2025 me afat aplikimi nga 25.03.2025 deri me date 23.04.2025; Lista e kandidatëve

të aprovuar, si dhe lista e kandidatëve të refuzuar lidhur me konkursin RN00017433; Vendimin për themelimin e komisionit të vlerësimit për pranim me nr. Protokolli 1-424/02 të datës 08.05.2025, Akt Emërimit e anëtarëve të komisionit të pranimit, Aplikacionin me dokumentet e bashkëngjitura të ankuesit, e-mailin njoftues nga Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil për caktimin e datës së testit me shkrim i datës 13.05.2025.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e parakohshme, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Industrisë Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me datë 24.03.2025 ka bërë shpalljen e konkursit me nr. reference RN00017433, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit, klasa e pozitës Drejtues i Ulët.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili me datë 02.05.2025 ka pranuar njoftimin nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, se nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme të procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit, me numër të referencës RN00017433 i shpallur nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për arsye se nuk ka ofruar: Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është e fituar jashtë, vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në proces të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë.

Ankuesi ka parashtruar ankesë të regjistruar me shenjë A.nr.811/2025 e protokolluar me nr.2952/2025, me pretendimin ankimor se plotëson kriterin dhe ka dorëzuar kopjen e diplomës e cila mund të dëshmohet përmes aplikimit në SIMBNJ kështu që kundërshton njoftimin e datës 02.05.2025 nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, se nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme të procedurës së rekrutimit për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit lidhur me konkursin me numër reference RN00017433 të datës 24.03.2025, për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit, klasa e pozitës Drejtues i Ulët.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë lidhur me konkursin për pranim me numër reference RN00017433 të datës 24.03.2025 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, me datë 02.05.2025 ka njoftuar, ankuesin se nuk i plotëson kriteret për përfshirje në listën e ngushtë, sepse aplikacionit të tij i mungon kopja e diplomës të kërkuar sipas konkursit.

Tutje nga administrimi i provave, Kolegji i Këshillit, konstanton se lista e kandidatëve të aprovuar, si dhe lista e kandidatëve të refuzuar lidhur me konkursin RN00017433 është lëshuar me datën 02.05.2025 dhe ankuesi është njoftuar në të njëjtën datë për mos përfshirje në listën e ngushtë. Në vazhdim të këtij procesi të rekrutimit bazuar në e-mailin njoftues të datës 13.05.2025 për mbajtjen e testit me shkrim konstatohet se është caktuar data e mbajtjes së testit me shkrim me datën 23.05.2025.

Lidhur me vendosjen në këtë çështje juridike administrative, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik konkretisht nenit 39 paragrafi 12 i cili

përcakton se: “12. Kandidatët/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenin 17 të Rregullores Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, është përcaktuar se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e datës 05.05.2025, kundër konkursit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, ndërsa sipas shkresave të lëndës rezulton se në kohën e parashtrimit të ankesës së ankuesit të datës 05.05.2025, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me nr. reference RN00017433 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin e Politikave të Turizmit, klasa e pozitës Drejtues i Ulët, në Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ngase sipas shkresave të lëndës, procedura e rekrutimit ka qenë në fazën e zhvillimit të testit me shkrim, për rrjedhojë Kolegji mbi bazë të konstatimeve si më sipër, vlerëson se ankesa e ankueses e datës 05.05.2025, pa u publikuar ende rezultatet përfundimtare është e parakohshme dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.811/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtëse

Malsore Gashi Bajraktari

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- G.H;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.
- Arkivit të KPMSHCK-së.